



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

PËRGJIGJA STRATEGJIKE PËR SHQIPËRINË – IPA III

PËRMBLEDHJE

Bashkimi Evropian është donatori më i madh për Shqipërinë. Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit (IPA) është instrument i financuar nga BE për Vendet e Ballkanin Perëndimor (Shqipërinë, Kosovën, Bosnjen dhe Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut) dhe Turqinë. IPA synon të mbështesë vendet kandidate dhe ato kandidate potenciale, në procesin e integritimit evropian. Më konkretisht, ka si qëllim të mbështesë zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike, të nevojshme për të sjellë vendet më pranë BE-së.

Nga Janari 2007 e më tej, Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) zëvendëson një seri programesh të Bashkimit Evropian dhe instrumenteve financiare për vendet kandidate ose vendet potenciale kandidate, përkatësisht PHARE, PHARE CBC, ISPA, SAPARD, CARDS. IPA programohet përmes cikleve 7 vjeçare. IPA I është programuar për periudhën 2007 – 2013, IPA II për periudhën 2014-2020, dhe IPA III po programohet për periudhën kohore 2021-2027. IPA III po programohet mbi bazën e Kuadrit Programues të IPA III, i cili përfaqëson një dokument strategjik të rëndësishëm të BE-së.

Kuadri Programues i IPA III përfshin 5 dritare strategjike;

Dritarja 1: Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia

Dritarja 2: Mirëqeverisja, linjëzimi me acquis të BE-së, fqinjësia e mirë dhe komunikimi strategjik

Dritarja 3: Konektiviteti i qendrueshëm dhe agjenda e gjelbër

Dritarja 4: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithë përfshirëse

Dritarja 5: Bashkëpunimi territorial dhe ndër-kufitar

Dritarja 1-4 artikulohen më tej në dokument sipas 17 prioritetëve tematike.

Përgjigja Strategjike e Shqipërisë për IPA III, e prezantuar nga Koordinatori Kombëtar IPA, është dokumenti kyç strategjik më i rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e fondeve IPA III, për periudhën 2021-2027.

Përgatitja e Përgjigjes Strategjike ka përfshirë të gjitha institucionet qendrore, pra ministritë e linjës, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, një numër agjensish publike dhe Institutin e Statistikave. Dokumenti, i draftuar sipas kërkesës së Komisionit Evropian, përshkuan mënyrën se si Shqipëria do të përdorë asistencën financiare të IPA III,

me qëllim që të kontribuojë në arritjen e objektivave të përcaktuara në Kuadrin Programues të IPA III.

Ky dokument siguron një artikulum të veprimeve të planifikuara përgjatë prioriteteve tematike brenda secilës prej pesë dritareve tematike. Përgjigja Strategjike ndahet në 5 seksione. Për secilin nga 4 dritaret e para, të identifikuar nga Komisioni Evropian, secila prej tyre ndahet në 2 pjesë, sipas modelit standard të përcaktuar nga Komisioni Evropian, për të gjitha vendet përfituese, me përmbajtjen e mëposhtme:

Hyrja

Seksionet 1, 2, 3, 4 (korresponduese me dritaret 1, 2, 3, 4 të IPA III)

Pjesa e parë - Konteksti sectorial dhe relevanca me politikat e zgjerimit

- 1 - Procesi i konsultimit.
- 2 - Linjëzimi i kuadrit strategjik të përfituesve me kuadrin programues të IPA III.
- 3 - Koherenca e kuadrit strategjik të përfituesve me Strategjinë e Zgjerimit të BE-së.
- 4 - Analiza sektoriale.
- 5 - Koherenca e strategjive sektoriale me strategjitë rajonale dhe ato globale

Pjesa e dytë - Prioritetet, politikat dhe veprimet nën asistencën financiare të IPA

- 1 - Procesi i konsultimit.
- 2 - Prioritetet kyçe tematike
- 3 - Lista e veprimeve për mbështetje nga IPA 2021 – 2024.
- 4 - Buxheti indikativ dhe plani i zbatimit për veprimet e IPA 2021 – 2024.

Seksioni 5 – Bashkëpunimi territorial dhe ndër-kufitar.

Pjesa e 1 ofron për çdo dritare nga 1-4, një analizë të kontekstit duke përkrahur në çfarë mase përparësitë e politikave dhe korniza strategjike e Shqipërisë janë në përputhje me orientimet strategjike të Kornizës së Programimit IPA III dhe janë koherente me politikën e zgjerimit, me qasjen sektoriale dhe me strategji të tjera rajonale dhe ndërkombëtare. Vëmendje e veçantë i është kushtuar fushave kryesore të kritereve të pranimit politik, duke përfshirë funksionimin e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar, lirinë e shprehjes dhe reformën e administratës publike, si dhe qeverisjen ekonomike. Për më tepër, vëmendje specifike në Përgjigjen Strategjike i është kushtuar përparimit të axhendës së gjelbër, kontributit në qëllimet e përcaktuara në Strategjinë e Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko-Jon dhe kontributit në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Pjesa e 2 jep një informacion për reformat parësore që janë identifikuar si ato më të rëndësishmet që adresojnë objektivat kryesore për një zhvillim dhe integrim të qëndrueshëm të Shqipërisë me Bashkimin Evropian, mbi bazat e dokumentave tre vjeçare më të rëndësishme kombëtare si Planin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe Programi për

Reformën Ekonomike. Strategjia e re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim aktualisht është duke u hartuar dhe ky dokument do të jetë dokumenti i politikave që do të mbulojë periudhën 2021-2030.

Pjesa e dytë prezanton gjithashtu listën e veprimeve për mbështetje nga IPA III për vitet programuese 2021 dhe 2022, sikurse janë prioritzuar nga Komisioni Evropian. Mbi bazën e paketës së propozimeve të përcjella nga Qeveria Shqiptare përmes Koordinatorit Kombëtar të IPA-s.

Seksioni 5 përshkruan shkurtimisht shtatë programet e Bashkëpunimit Territorial ku Shqipëria merr pjesë për periudhën 2021- 2027. Sidoqoftë, planifikimi i këtyre programeve do të kryhet përmes një procesi të veçantë që nuk mbulohet nga Përgjigja Strategjike Kombëtare.

Komisioni Evropian ka rekomanduar që Përgjigja Strategjike Kombëtare të konsultohet me grupet relevante të interesit, në përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes në Partneritet – Rregullore e Deleguar nga Komisioni me Nr. 240/2014 të 7 janarit 2014. Si rrejdhojë, dokumenti i Përgjigjës Strategjike Kombëtare i është komunikuar një numri të gjerë institucionësh, organizatash ose grupesh që mund të afektohen lehtësisht ose thellësisht nga zbatimi i fondeve të IPA III në Shqipëri, duke përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e grupeve të konsideruara si grupe të riskuara nga diskriminimi dhe përjashtimi social.